Workshop informues dhe konsultues mbi Kornizën e Integritetit Akademik në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër

Në kuadër të planit të veprimtarive (WP2), të projektit Erasmus+ SINCERE – "Strengthening Integrity and Ethical Culture in Regional Higher Education", në të cilin Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër është një nga institucionet partnere të konsorciumit, grupi i punës i projektit në UGJ organizoi një workshop informues dhe konsultues, të zhvilluar në dy seanca, mbi draftin e Kornizës së Integritetit Akademik.

Në këtë veprimtari, të zhvilluar në dy seanca, morën pjesë drejtues të universitetit, zëvendësrektorët, përgjegjës të njësive bazë, anëtarë të stafit akademik dhe Senatit Akademik, si dhe studentë të ciklit të parë Bachelor, ciklit të dytë Master dhe ciklit të tretë të studimeve të doktoraturës.

Qëllimi i workshop-it ishte njohja me përmbajtjen, parimet dhe mekanizmat e parashikuar në draftin e Kornizës së Integritetit Akademik, si dhe konsultimi i këtij dokumenti me grupet e interesit, në funksion të përshtatjes së tij me kontekstin institucional të universitetit.

Në pjesën e parë të takimit, u prezantuan elementet kryesore të Kornizës, duke u ndalur te parimet e integritetit akademik, rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve institucionalë, përdorimi etik i inteligjencës artificiale dhe mekanizmat për parandalimin dhe trajtimin e shkeljeve.

Në pjesën e dytë, pjesëmarrësit u përfshinë në procesin e konsultimit përmes plotësimit të pyetësorëve në platformën interaktive Slido, duke dhënë vlerësimet, mendimet dhe sugjerimet e tyre mbi qartësinë, zbatueshmërinë dhe drejtësinë e dispozitave të parashikuara në dokument.

Të dhënat dhe sugjerimet e mbledhura gjatë këtij procesi do të shërbejnë për rishikimin, përmirësimin dhe përshtatjen e draftit të Kornizës me nevojat dhe realitetin institucional të universitetit, përpara përgatitjes së versionit përfundimtar dhe paraqitjes së tij për miratim nga organet kolegjiale të universitetit.

Kjo veprimtari përbën një hap të rëndësishëm në procesin e konsultimit institucional dhe në angazhimin e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër për forcimin e kulturës së integritetit akademik, transparencës dhe përgjegjësisë në mësimdhënie, të nxënë, vlerësim dhe kërkim shkencor.








uk ka thjesht karakter informues,
sultues.
shtë të ndajmë me ju përmbajtjen
kryesore të Kornizës, por edhe të
ndimet dhe sugjerimet tuaja për
saj me kuadrin rregullator